

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Bujar Muzaqi dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. Z.A. nga Fshati S., Komuna e P., të cilin e përfaqëson e autorizuar Sh. Sh., avokate me seli në Rr. “...” .., Komuna P., kundër të paditurit N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., baza e kontestit pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e paditësit A. A., të autorizuarës së tij Sh. Sh. dhe të paditurit N.A., më dt.07.07.2016 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. Z. A. nga Fshati S., Komuna e P., **si e bazuar** dhe **VËRTETOHET** se i padituri N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., me dt.20.11.2015 e ka kryer pengimin e posedimit në dëmin e paditësit A. Z. A. nga Fshati S., Komuna e P., në atë mënyrë që i pa autorizuar dhe pa pëlqimin e paditësit i ka hjekë dhe dëmtuar rrethojat e metalta në gjatësi prej 150 metrash të patundshmërisë e evidentuar në Çertifikatën me numër 08/095/38844/2015 dhe atë njësinë kadastrale P-71712038-00503-0, Zona Kadastrale Sallabajë, vendi i quajtur “Iligja-T. B.”, tokë bujqësore, Arë e klasës së 4, në sipërfaqe prej 00.15.48 m², dhe njësisë kadastrale P-71712038-00505-0, Zona Kadastrale S., vendi i quajtur “Iligja-T. B.”, tokë bujqësore, arë e klasës së 5, në sipërfaqe prej 00.35.41 m².

I URDHËROHET të paditurit N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh ta kthej në gjendjen e mëparshme të posedimit në atë mënyrë që të i kthej rrethojat e metalta në gjatësi prej 150 metrash paditësit në paluajtshmërinë nga pika I., e këtij aktvendimi nën kanosje të përmbarimit me dhunë.

I NDALOHET të paditurit N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., që në të ardhmen në të njëjtën mënyrë ose mënyra të ngjashme ta pengoj paditësin A. Z. A. nga Fshati S., Komuna e P., në posedimin dhe shfrytëzimin e pasurisë nga pika I., e këtij aktvendimi.

DETYROHET i padituri N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., që t’ia bëjë të paditurit pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 176 €uro, si dhe të bëjë pagesën në Gjykatë në emër të taksës gjyqësore për Aktvendim në shumë prej 40 €uro e të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga momenti i pranimit të këtij aktvendimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi A. Z. A. nga Fshati S., Komuna e P., pranë Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega Podujevë me datë 17.12.2015 ka ushtruar padi kundër të paditurit N. O. A. nga Fshati S., Komuna e P., për pengim posedimi.

Paditësi përmes të autorizuarës së tij, në padi, parashtresë, në seancë, dhe në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se paditësi këto prona i ka trashëguar nga babai i tij dhe gjatë gjithë jetës i ka shfrytëzuar dhe disponuar në posedim të pandërprerë dhe në posedim të fundit faktik (gjendja e fundit) të patundshmërisë lëndore e evidentuar Çertifikatën me numër 08/714/35484/16 dhe atë njësinë kadastrale P-71712038-00503-0, dhe njësisë kadastrale P-71712038-00505-0 ZK S., të cilat prona i ka të kufizuara me një rrethojë, por që me dt.20.11.2015, i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e fundit të paluajtshmërisë lëndore dhe se i padituri e pengon në posedim paditësin, në atë mënyrë që hjek dhe dëmton rrethojën në gjatësi prej 150 metrash, me ç'rast paditësit i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

Lidhur me këtë ka lajmëruar Policinë e Kosovës, Stacionin Policor në P., dhe se i padituri e pranon këtë veprim të tij në polici, çka do të thotë se i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e pasurisë lëndore si dhe ushtrimin faktik në këtë pasuri.

Për shkak të këtyre veprimeve të të paditurit, paditësi kërkon mbrojtjen gjyqësore në kuptim të dispozitave të nenit 113 par.1 dhe 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (nr.03/L-154). Më tutje ka shtuar se bëjë përmirësimin e gabimi teknik në vend të parcelës 504 duhet të jetë P-71712038-00505-0, se e i padituri ka kryer aktin e pengimit të posedimit vërtetohet nga vetë pranimi i të paditurit në seancën e dt.14.06.2016 në të cilën ka pranuar se ka kryer aktin e pengimit të posedimit.

Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar, me një përmirësim të gabimit teknik në vend të parcelës 504 duhet të jetë P-71712038-505-0 në pjesën tjetër kërkesëpadija e paditësit mbetet e pa ndryshuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 40 €, në emër të përfaqshmit nga ana e avokatit për seancë gjyqësore shumë prej 136 €.

I padituri në përgjigje në padi të parashtruar në Gjykatë me datë 05.04.2016, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa po në këtë përgjigje në padi ndër të tjera ka deklaruar se **“... gjyshi i tij E. A. A. gjatë vitit 1957 në bazë të marrëveshjes gojore e kishte blerë nga shitësi Z. A., nga f. S., një pjesë të ngast. Kadas.nr.505 në sipërfaqe prej 0.12.55 ha, ndërsa kjo ngast. 505 ka sipërfaqen e përgjithshme 0.35.41ha, nga kjo ngaster kishte blerë vetëm sipërfaqen prej 0.12.55 ha, që nga viti 1957 ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar nga askush paraardhësi i të paditurit dhe vet i padituri. Por me dt. 20.11.2015 paditësi herët në mengjez kishte filluar që ta rrethoj pronën e të paditurit dhe vëllaut të tij Q. A..”** Ndërsa në seancën përgatitore të mbajtur me datë 14.06.2016 ndër të tjera ka deklaruar se **“... e kam prish rrethojën e kam prish për vet faktin se nuk ka qenë në vendin adekuat, pjesa tjetër e tokës është e jona, po ashtu me qen se ky supozon se kjo është e tij ky është dashtë të jetë me bashkëpunues dhe të na njoftoj neve dhe ti vendosim pikat bashkërisht”**. Po ashtu edhe në fjalën përfundimtare të

dt.07.07.2016 ndër të tjera ka deklaruar se “ **Me letra kjo pronë i takon paditësit, mirëpo moralisht kjo pronë është familjes ton gjegjësisht e babagjyshit ton gjegjësisht babagjyshi i ka blerë ...**”.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata për të vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile në procedurën kontestimore bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave: u lexua fleta poseduese nr.08-095-38844/2015 datë 08.04.2015, Vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Stacioni Policor i P. Referenca nr.04/1-01, PH/1072/2015, nr. i rastit 2015-AF-0949 e dt.08.12.2015, Deklaratë e Paditësit A. A. dt.16.12.2015, Njoftimi Publik i lëshuar nga Drejtoria për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi me nr.08-464-55273 dt.23.06.2014.

Meqenëse palët ndërgjygjëse nuk patën prova dhe propozime të reja, as nuk kanë propozuar dëshmitar, daljen në vend ngjarje të gjykatës, atëherë gjykata bëri vlerësimin e tyre një nga një e të gjithave së bashku konform nenit 8 të Ligjit nr.03/1 - 006 për Procedurën Kontestimore, dhe vërtetoi se padia dhe kërkesëpafia e paditësit është e bazuar dhe si të tillë e aprovoi siç është cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga fleta poseduese nr.08-095-38844/2015 datë 08.04.2015, gjykata vërtetoi se paditësi është pronar i patundshmërisë kontestuese respektivisht ngastrës kadastrale P-71712038-505-0 dhe P-71712038-503-0 për të cilën pretendon se është bërë-kryer akti i pengim posedimi, gjithashtu nga fleta poseduese vërtetohet fakti se paditësi ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar të paluajtshmërisë-ngastrës kontestuese deri me rastin e aktit të pengim posedimit.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë – Stacioni Policor i Podujevës Referenca nr.04/1-01, PH/1072/2015, nr. i rastit 2015-AF-0949 e dt.08.12.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka lajmëruar policinë ngase nga prona e tij i është hequr dhe dëmtuar rrethoja e metaltë në gjatësi prej 150 metra, dhe si i dyshuar-dëmtues është tani i padituri N. O. A., gjithashtu u vërtetua fakti se i padituri e ka pranuar se ka kryer aktin e dëmtimit-heqjes së rrethojës, respektivisht se ka kryer aktin e pengimit të posedimit.

Nga deklarata e paditësit e dt.16.12.2015 vërtetohet fakti se paditësi ka njoftuar policinë për rastin, si dhe ka identifikuar personat të cilët kanë bërë dëmtimin e rrethojës duke e hequr atë e ky është tani i padituri N. A..

Nga vërtetimi nr.04/1-01 dt.08.12.2015, i lëshuar nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Podujevë u konstatua se i padituri N. A. në Polici e ka pranuar veprën në tërsi.

Po ashtu i padituri edhe në seancën përgatitore të dt.14.06.2016 ndër të tjera ka deklaruar se “**... e kam prish rrethojën e kam prish për vet faktin se nuk ka qen ne vendin adekuat, pjesa tjetër e tokës është e jona, po ashtu me qen se ky supozon se kjo është e tij ky është dashtë te jetë me bashkëpunues dhe te na njoftoj neve dhe ti vendosim pikat bashkërisht**”.

Nga Njoftimi Publik i lëshuar nga Drejtoria për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi me nr.08-464-55273 dt.23.06.2014, gjykata vërtetoi faktin se ky njoftim publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, ka të bëjë me ngastrën kadastrale nr. 71712038-00502-0, me sipërfaqe prej 3147 m², ZK S., dhe si i tillë nuk ka të bëjë me ngastrën kontestuese dhe si tillë nuk është i ndonjë rëndësie dhe nuk ka ndikim në zgjidhjen e çështjes kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Sa i përket vërtetimit të vendit se ku dhe kur është kryer akti i pengimit të posedimit gjykata këtë e vërtetoi nga vetë deklarimi i palëve ndërgjyqëse në seancë, të cilat deklaruan se akti i pengimit të posedimit është kryer në ngastrën kadastrale nr. P-71712038-505-0 dhe P-71712038-503-0, gjithashtu kjo vërtetohet edhe me provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në këtë kontest nuk është objekt shqyrtimi pronësia- se kush është pronar dhe si e ka ardhur deri te fitimi i pronësisë, por fakti se kush e ka pushtetin faktik-posedimin mbi patundshmërinë e këtë e ka në rastin konkret paditësi, kjo vërtetohet me prova dhe nga vetë deklarimi i palëve ndërgjyqëse, andaj këtu kemi aktin e pengim posedimit, sepse në nenin 103 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, thuhet se **“Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë**, në rastin konkret kemi të bëjmë me posedim pronësorë dhe gjendjen e fundit si posedues kemi paditësin i cili në këtë paluajtshmëri e ka posedimin e sendit dhe e ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimin e drejtpërdrejtë), sipas nenit 103 të Ligjit për pronën dhe të drejtat sendore.

Duke pasur parasysh se procedura për pengim posedimi ka për qëllim vendosjen e gjendjes së fundit faktike të posedimit dhe me padinë e paditësit mund të kërkohet një gjë e tillë konform nenit 113 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat sendore, i cili parasheh se **“Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”**.

Gjykata fitojë këtë bindje dhe kjo bindje u fitua me prova në mënyrë të padyshimtë në procedurë por edhe nga vetë pranimi i palëve ndërgjyqëse se paditësi është penguar në përdorimin dhe posedimin e palujtshmërisë në mënyrë të kundërligjshme kundër vullnetit të tij, andaj kërkesëpadia e tij si e tillë edhe është aprovuar.

Andaj, pas vlerësimit të tillë të gjendjes, deklarimi i palëve, provat e administruara, gjykata gjeti se kemi të bëjmë me pengimin e posedimit nga ana e të paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e mori konform nenit 449, 450 dhe nenit 452.1 të Ligjit nr.03/1 -006 për Procedurën Kontestimore dhe udhëzimit administrativ 2008/2 të KGJK-së, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimet e KGJK-së, për Unifikimin e taksave gjyqësore dhe u obligua i padituri t'ia paguaj të paditurit shumën e përgjithshme prej 176 €, prej tyre shuma prej 40 € në emër të taksës

gjqësore për padi, si dhe shumën prej 136 € për një seancë për përfaqësim të avokatit, si dhe në llogarinë e Gjykatës shumën prej 40 €uro në emër të taksës gjyqësore për aktvendim (neni 10.13 i Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 i lëshuar nga KGJK).

Nga sa u tha më lartë vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 478, 480, 481.2 të Ligjit nr.03/1 -006 për Procedurën Kontestimore, nenit 110 dhe 113 të Ligjit nr.03/L-154 mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil
C.nr.610/2015 të dt.07.07.2016

Gjyqtari,
Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.